



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:035434
Datë: 10.06.2022
Numri i dokumentit: 03121233

PS.nr.22/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti Special, kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Kujtim Krasniqi, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.M. për shkak veprës penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par 3 lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.10/2022, të datës 22.02.2022 dhe aktakuzën e precizuar PPS.nr.10/2022 të datës 04.04.2022 pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datën 01.06.2022, në prezencën e Prokurorit të PSRK-së Rafet Halimi, të akuzuarit F.M., me mbrojtësin av.Shkelzen Sopjani, me datë: 02.06.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt:10.06.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.M., nga babai M. dhe nëna H., e vajzërisë Th., i lindur me datë ... në P., me vendbanim në rrugën “V. e P.”, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, Shqiptar – shtetas i RKS-së,

ËSHTË FAJTORË

Sepse,

Nga data 01/07/2020 deri me datë 24/02/2021, në Prishtinë dhe Pejë, i pandehuri F.M. me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pa sakta në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në atë mënyrë që, me 28.08.2020 i pandehuri F.M. paraqet kërkesën nr.21/154022, në Komunën e Pejës për të përfituar subvencion nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për kulturën grurë në sipërfaqe në sipërfaqe 109 hektar, si dhe me 12.10.2020 i pandehuri F.M. në komunën e Pejës paraqet kërkesën nr.07/4-5373 për ndërrimin e kulturës dhe pas disa ditësh nga S. S. pranon një certifikatë të lëshuar nga trupa kontrolluese “Bio-Q-Check” në mënyrë të kundërligjshme e për të cilën i paguan S. S. shumën 3,500.00 €, pastaj në bazë të këtyre të dhënave të rrejshme Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ekzekuton pagesat në dy këste dhe i pandehuri pranon në llogarinë e tij bankare pjesën e parë shumën 54,760.00 €, ndërsa pjesën e dytë 54,760.00 €, me këto veprime i pandehuri i shkakton dëm në shkallë të madhe buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerë 109,520.00 €,-

- me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim Me Subvencione nga neni 324 par 3 lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, në bazë të neneve 4,7, 17, 38,39,40, 42, 43,44, 59, të KPRK-së, si dhe 365 dhe 248 të KPRK-së të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë)** Muaj,

Në bazë të nenit 44 të KPRK, me propozimin dhe pajtimin e palëve dënimi me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë në shume prej 5000 (pesëmijë) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj 15(pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 30.06.2021 e deri më dt.12.11.2021 i llogaritet në dënimin me gjobë të shqiptuar.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të shqiptuar, konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

konfiskohet : shuma e mjeteve monetare në vlerë prej 27,000.00(njëzet e shtatë mijë)€

Obligohet: që në emër të dëmit të shkaktuar Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të paguaj shumën totale 109,520.00 €, -euro

Obligohet: që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

E dëmtuara: Qeveria e Kosovës-Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në lidhje me kërkesat eventuale pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS.nr.10/2022 të dt. 22.02.2022 dhe aktakuzën e precizuar PPS.nr.10/2022 të datës 04.04.2022, kundër të pandehurit F.M. për shkak veprës penale Mashtrimi me subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së, Si dhe të akuzuarve të tjerë si në aktakuzën PPS.nr.10/2022 të datës 04.04.2022.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 01.06.2022, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i PSRK-së, gjykata i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet lidhur me fajësinë.

Pasi që në fillim të shqyrtimit fillestar, i pandehuri në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, ka pranuar fajësinë për veprën penale Mashtrim Me Subvencione nga neni 324 par 3 lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjykata në rastin konkret, lidhur me pranimin e fajësisë, pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, i cili është deklaruar që të aprovohet pranimi i fajësisë nga të pandehurit dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në mënyre vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 1, nën – par. 4 të KPPRK-së, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimin të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që për të F.M. si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranojnë fajësinë për veprën penale, është penduar dhe gjykatës i kanë premtuar se nuk do të përsërisim vepra të tilla ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, dhe nisur nga të gjitha këto të thëna gjykata i shqiptoi dënim me kusht me bindje se në rastin konkret është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me dënim e shqiptua si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2 të KPRK-së, me shkallën dhe përgjegjësinë e tij, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit të veprës penale si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Pas vlerësimit të aktakuzës lidhur me demin e shkaktuar dhe analizimit të pranim të fajësisë në raport me dispozitivin e aktakuzës, gjykata në bazë të nenit 458 par.2 të KPP-së të akuzuarin e ka obliguar që në emër të dëmit të shkaktuar ti kompensojnë të dëmtuarës shumën e cekur si në dispozitivin e aktakuzës.

Vendimi për konfiskimin e shumes së mjeteve monetare në vlerë prej 27,000.00(njëzet e shtatëmijë) Euro u mor në pajtim me nenin 115 par.1,2 dhe 4 të KPPRK-së, pasi që të njëjtat janë

përfitur si rezultat i veprës penale për të cilën akuzuari pas pranimi të fajësisë është shpallur fajtorë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 451, paragrafi 1, 453 paragrafi 1 dhe nenit 463 të KPP-së.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të nenit 365 dhe 248 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti Special

PS.nr.22/2022, dt.10.06.2022

Zyrtar Ligjor,
Leutrim Hoti

Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.